



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Prishtinë shpall:

---

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

<b>Emri i grupit</b>	Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës
<b>Institucioni</b>	Komuna Prishtinë
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010927
<b>Kodi</b>	RPC0004583
<b>Data e njoftimit</b>	03.02.2023
<b>Afati për aplikim</b>	24.02.2023 - 03.03.2023

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Harton propozim planin vjetor të shfrytëzimit të pyjeve, punëve të silvikulturës pyjore dhe mbrojtjes të pyjeve,
- Analizon dhe shqyrton planet pas pranimit nga Agjencia e Pyjore e Kosovës – APK,
- Merr pjese në shqyrtimin dhe analizimin e planeve afatgjate të menagjimit të pyjeve për njësite menagjuese që shtrihen në territorin e Komunës së Prishtinës,
- Udhëheq Komisionet e vërtetimit të demit pyjore (revizionet), dorëzimit të parcelave pyjore kompanive të tenderëve të shfrytëzimit të pyjeve si dhe pranimin e të njëjtave,
- Kompletton fletëparaqitjet për kundërvajtje dhe penale të ngritura si procedure administrative nga rojet e pyjeve si dhe merr pjese në inicim të procedurave penale dhe kundërvajtje,
- Merr pjese në hartimin e raporteve mujore dhe periodike të punës së sektorit të pylltarisë,
- Sipas autorizimit përfaqëson sektorin në Gjykata dhe Prokurori në mbrojtjen e lendeve që kanë të bëjnë me Pyjet dhe tokat Pyjore,
- Përgatitë të dhënat për zhvillimin e procedurave të prokurimit për shfrytëzimin e pyjeve dhe punës të silvikulturës pyjore,
- Kontrollon dhe monitoron pyllëzimet, ripyllëzimet, shfrytëzimin e rregullt të pyjeve, prerjet paratregtare dhe aktivitetet tjera që zhvillohen në territorin e Komunës së Prishtinës,
- Merr pjese në shqyrtimin e kërkesave të pronareve të pyjeve privat dhe lëshimit të lejeve për prerje,
- Përgatitë masat dhe kriteret e dhënies me qera të vendgjyjetive të përbashkëta,
- Të kryejë edhe punë tjera të ngjashme të përcaktuara me ligj dhe rregulloret e komunës sipas kërkesës së Udhëheqësit të Sektorit dhe Drejtorit.

Për punën e tij i raporton udhëheqësit të drejtpërdrejt

## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.





## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

---

Ligji për zyrtar publik 06/L-114

Ligjet tjera zbatuese nga Komuna e Prishtinës

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

**Të dhëna shtesë:**

**VËREJTJE:**

**Koeficienti i përcaktuar për këtë konkurs është subjekt i harmonizimit konform ligjit të ri të pagave kurdo që hynë në fuqi ky ligj!**

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

